



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.290/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të znj. Kimete Gashi – Kryetare, Agon Ramadani- Anëtar dhe Nita Bejta – Referuese, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Office Kosova”– Prizren, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekat shkollore”, me nr. të prok: 616-22-6625-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Prishtinë”, më datën: 12.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Office Kosova”– Prizren, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekat shkollore”, me nr. të prok: 616-22-6625-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Prishtinë”.

II. VËRTETOHET njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekat shkollore”, me nr. të prok: 616-22-6625-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Prishtinë”, të vazhdoj me procedurat e mëtejshme

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Office Kosova”– Prizren, është refuzuar behet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Office Kosova”– Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.07.2022 me nr. 290/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me libra për bibliotekat shkollore”, me nr. të prok: 616-22-6625-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 52 , 53 , si dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04.08.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Office Kosova”– Prizren,

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizim me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit kontratë, përkatësisht kundër kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional ku AK - Komuna Prishtine, ka kërkuar:

2. ”OE-ik duhet te ofroj dëshmi se ka marrëveshje për furnizim me libra nga shtëpitë botuese sipas emrave dhe titujve., Marrëveshja ORIG.JINALE me shtëpitë botuese për furnizim të artikujve ”. Kundër të njëjtës kërkesë, OE “Office Kosova” - Prizren, me teje si parashtruesi i ankesës, me datën 20.07.2022, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim me kërkesë qe te largohet e njëjta kërkesës pasi qe si e tille kufizon konkurrencën.

AK - Komuna Prishtine, përmes vendimit te datës 21.07.2022, refuzon kërkesën si te pa bazuar dhe le ne fuqi vendimin - njoftimin për kontrate me arsyetimin kryesore se te drejtat autoriale te titujve te botuar dhe te cilët kane marrëveshje ligjore me autoret e librave për shitjen e tyre. Ju jeni te obliguar ligjërisht qe për te përfaqësuar titujt e një autori me te drejte ekskluzive autoriale duhet te keni marrëveshje me shtëpitë botuese te cilët kane marrëveshje ligjore me autoret e librave.

Përgjigje në pretendimin ankimore (neni 113) : Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se neni 88, i Ligjit Nr. 04/L-065, për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta, nga paragrafi I deri 5 përcaktojnë:

1.Me kontratë botimi autori ia kalon të drejtën botuesit për të riprodhuar veprën e tij me anë të shtypshkrimit dhe të drejtën për shpërndarje të ekzemplarëve të veprës, ndërkaq botuesi merr për detyrim të bëjë riprodhimin dhe shpërndarjen e veprës si dhe për këtë t' i paguajë autorit kompensimin. 2.Në rastin kur vepra nuk është e publikuar me kontratë për botim të veprës konsiderohet se është dhënë pëlqimi edhe për publikimin e saj. 3.Me kontratë për botim botuesi mund të autorizohet edhe për përkthim të veprës në një gjuhë tjetër, si dhe për riprodhim dhe shpërndarje të saj. 4.Kontrata për botimin, objekt i së cilës është botimi i artikujve, vizatimeve, karikaturave dhe kontributeve tjera të autorit në shtypin ditor dhe atë periodik, nuk është e domosdoshme të bëhet në formë të shkruar. 5.Përfaqësuesi i autorit mund të lidhë kontratë për botim vetëm për ato vepra që janë caktuar shprehimisht në autorizimin e autorit ". AK - Komuna Prishtine, përmes pozicionit 2, të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional ka kërkuar: "OE-ik duhet të ofroj dëshmi se ka marrëveshje për furnizim me libra nga shtëpitë botuese sipas emrave dhe titujve., Marrëveshja ORIGJINALE me shtëpitë botuese për furnizim të artikujve "

-Përderisa po ti referohemi para masës dhe para llogarisë rezultojnë qe AK - Titujt e librave për autoret e tyre ka identifikuar dhe përcaktuar gjithsejtë dhjete (10) shtëpi botuese: "Albas", "Dukagjini", "Efekos", "Mediaprint", "Magjia e Librit", "Argeta", "Pegi", "Utalaya Foundation", "Mediaprint" dhe "Magjia e Librit". Ndërsa sasia e kërkuar është nga 224, libra për secilin titull. Pra me aplikim të tillë ofertuesit e interesuar për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit detyrimisht do duhej të prezantojnë marrëveshje të veçanta për secilën shtëpi botuese të përcaktuar nga AK - Komuna Prishtine. Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës në ankese potencion se disa nga titujt e kërkuar nga AK, janë të botuara nga mbi 8 shtëpi botuese, rrjedhimisht përcaktimi i shtëpive botuese bie ndesh me parimet kryesore të prokurimit publik.

AK -Komuna Prishtinë, për të arritur qëllimin e kontratës, me aplikim të procedurës së tillë (procedurë e hapur) detyrimisht do të duhej të beje ndarjen e kontratës në lote - pjese, në kuptim të nenit 27/A, të LPP-se, meqë shtëpitë botuese i ka identifikuar si të vetme të autorizuar për shitje, këtë e mbështesim në paragrafi 3, i nenit 51, të LPP-se, Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse".

Përfundimisht, bazuar në atë që u tha si më lartë, propozimi ynë për AK- Komuna Prishtine, është që kjo procedurë e prokurimit të anulohet në tërësi dhe në rast të ri tenderimit, përkatësisht:

-Nëse AK- Komuna Prishtine, e ka të ditur se titujt dhe autoret e librave për të cilat pretendon të prokuroj, janë të autorizuar për shitje vetëm nga shtëpitë botuese të përcaktuara nga AK, të aplikoji procedurë të negociuar, në kuptim të nenit 35, të LPP-se, përkatësisht paragrafit 2.1. çfarëdo kontrate publike, pika (i) nëse, për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet të epet një operatori të caktuar ekonomik;

-Nëse kundërtën nëse ekzistojnë edhe shtëpi botuese tjera siç potencion parashtruesi i ankesës, të aplikon procedurë të hapur dhe të aplikoji masa tjera të sigurisë siç është "ISBN" e librit dhe të kërkohen titujt dhe autoret e librave dhe të mos përcaktohen shtëpitë botuese, përkatësisht të largohet kërkesa për ofrim të marrëveshjes me shtëpi botuese pasi që bie ndesh me parimet kryesore të prokurimit publik. Sqarimi i publikuar nga zyra e ISBN-se për Kosovë - biblioteka kombëtare dhe Universitare e Kosovës: Botuesit Integrimi në sistemin e ISBN-së për botuesit ka rëndësi të veçantë. ISBN, si identifikues unik, shërben për:

- Identifikimin e botimeve monografike nga dorëshkrimi deri te redaktimi, procesi i prodhimit dhe dalja në publik;
- Kontrollin e fondit të titujve;
- Porositjen dhe shpërndarjen e titujve;
- Monitorimin e të dhënave të shitjes dhe shpërndarjes së titujve.

Tregtuesit e librit ISBN, si identifikues unik nga tregtuesit e librit, përdoret për:

- Porositjen dhe shpërndarjen e titujve;
- Mbajtjen e llogarive dhe faturimin;
- Kërkimet bibliografike;
- Menaxhimin e sistemit të shitjes.

Si prove se bashku me raport gjeni - para masën dhe para llogarinë e hartuar nga AK. Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, "Office Kosova" - Prizren të aprovohet si e bazuar, te anulohet vendimi i AK-se - njoftimi për kontrate dhe lënda te Ri tenderohet, nëse AK, ende shpreh interes për procedure te prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, "Office Kosova" - Prizren të aprovohet si e bazuar, te anulohet vendimi i AK-se - njoftimi për kontrate dhe lënda te Ri tenderohet, nëse AK, ende shpreh interes për procedure te prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 04.08.2022, me raportin e ekspertizës.

Seanca e mbyllur për shqyrtimin kryesore është mbajtur me datën: 12.09.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit

ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, vlerëson se Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka vendosur njoftimin për kontratë me arsyetimin kryesor se te drejtat autoriale të titujve të botuar duhet të kenë marrëveshje ligjore me autoret e librave për shitjen e tyre.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka kërkuar që Operatorët Ekonomik ofertues që të jenë ligjërisht përfaqësues të titujve të një autori me te drejte ekskluzive autoriale duhet të jenë të pajisur me marrëveshje me shtëpitë botuese të cilët kanë marrëveshje ligjore me autoret e librave.

Paneli Shqyrtues vlerëson se AK nuk ka bere shkelje te nenit 28 të LPP-se meqë e njëjta është e obliguar të respektoj marrëveshjet e autoreve me shtëpitë botuese përkatëse dhe atë në kuptim të nenit 88 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Paneli shqyrtues duke zbatuar dispozitën ligjore nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale -Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK - Prishtinë”,
- 1x1 OE - “Office Kosova” – Prizren,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

